



**Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission**  
*Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova*

**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63, nenin 64.2 dhe nenin 96 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe nenin 3 të Rregullores Zgjedhore Nr. 17/2024, Regjistrimi dhe Votimi Jashtë Kosovës, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datë 04.01.2025, nxjerr këtë:

## VENDIM

### Për Miratimin e Mbylljes së Dy Qendrave të Votimit në Përfaqësi Diplomatike

- I. Në Qendrën e votimit në përfaqësitë diplomatike në Podgoricë dhe në Tiranë, për arsye të numrit të vogël të votuesve të regjistruar nuk do të organizohet procesi i votimit, për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, që do të mbahen më 9 shkurt 2025.
- II. Udhëzohen votuesit e qendrave si në pikën I t këtij vendimi të dërgojnë votat në kutitë postare jashtë Kosovës.
- III. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 04.01.2025

  
**Kreshnik RADONIQI**  
Kryesues i KQZ



**Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission**  
*Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova*

**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63, 64, nenin 70 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, neni 6, paragrafi 1.4 dhe nenin 8 paragrafi 1 të Rregullores Zgjedhore Nr.02/2024, Emërimi, Përbërja dhe Funksonimi i Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve, si dhe kërkesës, të datës 03.01.2025, të subjektit politik VV, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 04.01.2025, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**Për emërimin dhe zëvendësimin e anëtarit të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ) në Komunën e Malishevës**

- I. Znj. Vlora Bytyqi, emërohet anëtare e KKZ-së në komunën e Malishevës nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje -LVV, duke e zëvendësuar znj. Bukurije Rustemi nga i njëjti subjekt politik, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 9 Shkurt 2025.
- II. Mandati i anëtarit të emëruar të KKZ-së, do të fillojë nga data e emërimit sipas këtij vendimi dhe do të përfundojë pesëmbëdhjetë (15) ditë pas certifikimit të rezultatit të zgjedhjeve, përveç nëse mandati i KKZ-së ndërpritet para përfundimit të afatit ose zgjatet me vendim të KQZ-së.
- III. Obligohet Sekretariati i KQZ për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Me vendimin e KQZ-së Nr.01/289-2024, të datës 16.09.2024, znj. Bukurije Rustemi subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje -LVV, është emëruar anëtare e KKZ-së, ndërsa me kërkesën e subjektit politik në fjalë, të datës 03.01.2025, ka kërkuar zëvendësimin e saj për arsyeje personale. Andaj, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, 04.01.2025





**Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission**  
**Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova**

**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63, 64, nenin 70 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, neni 6, paragrafi 1.4 dhe nenin 8 paragrafi 1 të Rregullores Zgjedhore Nr.02/2024, Emërimi, Përbërja dhe Funksionimi i Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve, si dhe kërkesës, të datës 31.12.2024, të subjektit politik GISPO, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 04.01.2025, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**Për emërimin dhe zëvendësimin e anëtarit të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ) në Komunën e Zveçanit**

- I. Znj. Valentina Djerković, emërohet anëtare e KKZ-së në komunën e Zveçanit nga subjekti politik GISPO, duke e zëvendësuar znj. Mira Zdravković, nga i njëjti subjekt politik, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 9 Shkurt 2025.
- II. Mandati i anëtarit të emëruar të KKZ-së, do të fillojë nga data e emërimit sipas këtij vendimi dhe do të përfundojë pesëmbëdhjetë (15) ditë pas certifikimit të rezultatit të zgjedhjeve, përveç nëse mandati i KKZ-së ndërpritet para përfundimit të afatit ose zgjatet me vendim të KQZ-së.
- III. Obligohet Sekretariati i KQZ për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Me vendimin e KQZ-së Nr.01/289-2024, të datës 16.09.2024, znj.Mire Zdravković, nga subjekti politik GISPO, është emëruar anëtare e KKZ-së, ndërsa me kërkesën e subjektit politik në fjalë, të datës 31.12.2024, ka kërkuar zëvendësimin e saj. Andaj, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, 04.01.2025





**Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission**  
*Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosovo*

**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63, nenin 64.2 dhe nenin 82 paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe nenin 7 paragrafin 3 të Rregullores Zgjedhore Nr. 03/2024 Krijimi, Kundërshtimi dhe Konfirmimi i Listës së Votuesve, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datë 04.01.2025, nxjerr këtë:

**VENDIM**

**Për Miratimin e Rekomandimit për Caktimin e Numrit Maksimal të Votuesve në Vendvotime**

- I. Miratohet Rekomandimi i Sekretariatit të KQZ, për caktimin e numrit maksimal të votuesve në vendvotime për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, që do të mbahen më 9 shkurt 2025.
- II. Numri maksimal i votuesve në një vendvotim për zonat rurale do të jetë 999 votues.
- III. Numri maksimal i votuese në një vendvotim për zonat urbane do të jetë 950 votues.
- IV. Rekomandimi si në pikën I, është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- V. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, për zbatimin e këtij vendimi.
- VI. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 04.01.2025





**Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission**  
*Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova*

**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63, nenin 64 paragrafi 2.1 si dhe nenin 83 paragrafi 1 dhe paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datën 04.01.2025, nxjerr këtë:

### VENDIM

#### **Për Miratimin e Rekomandimit për Ndërrimin e Qendrës së Votimit (QV) në Pejë**

- I. Miratohet rekomandimi i Kryesuesit të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ) në Pejë, për zhvendosjen e Qendrës së Votimit nga objekti i Shkollës Fillore e Mesme e Ulët "7 shtatori" në Vitomericë në objektin e Shkollës Ekonomike Profesionale "Ali Hadri".
- II. Rekomandimi si në pikën I, është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- III. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 04.01.2025

  
**Kreshnik RADONIQI**  
Kryesues i KQZ





**Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission**  
*Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosovo*

**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 7, nenin 8, nenin 63 dhe nenin 64 paragrafi 2 nën paragrafi 7 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe neni 7 të Rregullores Zgjedhore Nr. 03/2024 Krijimi, Kundërshtimi dhe Konfirmimi i Listës së Votuesve në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datë 04.01.2025, nxjerr këtë;

## VENDIM

### Për Certifikimin e Listës Përfundimtare të Votuesve

- I. Certifikohet Lista Përfundimtare e Votuesve, për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, që do të mbahen më 9 shkurt 2025.
- II. Raporti i Listës Përfundimtare të Votuesve është pjesë përbërës e këtij vendimi.
- III. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 04.01.2025

**Kreshnik RADONIQI**  
Kryesues i KQZ



**Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission**  
*Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova*

**Lista Votuesve për Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës  
së Kosovës - 9 shkurt 2025**

## Përmbajtja

1	Hyrje.....	3
2	Krijimi i listës së votuesve.....	3
2.1	Largimi i personave që u është hequr zotësia e veprimit.....	3
2.2	Largimi i personave nga verifikimi me institucionet tjera.....	3
2.3	Periodha e shërbimit të votuesve për ndërrimin e qendrës së votimit.....	4
2.4	Kundërshtimi i listës së votuesve.....	4
3	Regjistrimi i votuesve jashtë Kosovës.....	4
3.1	Kundërshtimi administrativ dhe ankesat në PZAP.....	5
4	Lista e votuesve jashtë Kosovës.....	5
5	Lista e Votuesve brenda Kosovës.....	10



## **1 Hyrje**

Konform Planit të Aktiviteteve për organizimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Kosovës që mbahen me 9 shkurt 2025, pas përfundimit të periudhës së kundërshtimit dhe konfirmimit të listës së votuesve, si dhe periudhës për regjistrimin e votuesve jashtë Kosovës, Divizioni për Shërbimin e Votuesve (DSHV) paraqet raportin e listës së votuesve për certifikim nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ).

Listën e votuesve bazohet në të dhënat e Regjistrimit Qendror Civil (RQC) të Agjencisë për Regjistrim Civil (ARC) në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB). Me qëllim të përgatitjes së listës së votuesve janë marrë 3 ekstrakte të shtetasve nga ARC, përkatësisht Departamenti i Gjendjes Civile (DGJC) dhe Departamenti për Prodhimin e Dokumenteve (DPD).

Lista e votuesve përmban 2,075,868 votues. Kjo listë përfshinë shtetasit me të drejtë vote që arrijnë moshën 18 vjeç, me datë 9 shkurt 2025. Për dallim nga Zgjedhjet Lokale 2021 të datës 17 tetor 2021, numri i votuesve është më i madh për 174,888 votues. Prej tyre 125,852 janë votues të rinjë që kanë mbushur 18 vjet ndërmjet dy proceseve zgjedhore.

Numri i votuesve në listën e votuesve brenda Kosovës është 1,970,944 votues dhe 104,924 votues në listën e votuesve jashtë Kosovës.

Numri i qendrave të rregullta të votimit në Kosovë është 903 dhe 2533 vendvotime të rregullta. Gjithashtu, KQZ ka aprovuar për këto zgjedhje edhe 38 qendra të votimit me kusht me 56 vendvotime.

## **2 Krijimi i listës së votuesve**

Ekstraktet e para të RQC janë pranuar nga ARC me datën 20 gusht 2024. Pas pranimit të ekstrakteve, është përpiluar raporti i listës preliminare të votuesve i cili është aprovuar nga KQZ në mbledhjen nr.45 me datë 28 gusht 2024. Lista preliminare e votuesve është publikuar në platformën elektronike me datë 29 gusht 2024.

### **2.1 Largimi i personave që u është hequr zotësia e veprimit**

DSHV me datë 19 gusht 2024 ka kërkuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) listën e personave të cilëve, u është marrë zotësia e veprimit me vendim gjyqësor. Me datë 10 shtator 2024, nga KGJK është pranuar lista me 251 persona të cilët me vendim gjyqësor të formës së prerë u është marrë zotësia e veprimit. Pas identifikimit bazuar në të dhënat personale, janë larguar 160 persona nga lista e votuesve.

### **2.2 Largimi i personave nga verifikimi me institucionet tjera.**

DSHV, ka kërkuar informata nga Departamenti i Pensioneve (DP), dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) me qëllim të saktësimit të listës së votuesve. Në të njëjtën datë, ASK konfirmoi se personi më i vjetër i regjistruar kishte vitin e lindjes 1909 (një shtetas nga Komuna e Obiliqit). Pas verifikimit, janë larguar nga lista e votuesve 915

votues, prej të cilëve 445 votues sipas informatave nga DP dhe 470 votues sipas analizës bazuar në të dhënat e ASK. Gjithashtu, sipas vendimit të KQZ-së personat që kanë moshën mbi 100 vjeç që gjenden në DGJC dhe të cilët nuk figurojnë në DPD, nuk janë përfshirë në listën e votuesve.

### **2.3 Periudha e shërbimit të votuesve për ndërrimin e qendrës së votimit**

Periudha e Shërbimit të Votuesve ka filluar me datën 29 gusht 2024 dhe ka përfunduar me datën 26 dhjetor 2024, ku votuesit kanë pasur mundësi të informohen për qendrën e votimit ku janë caktuar dhe të kërkojnë ndërrimin e qendrës së votimit. Gjatë kësaj periudhe janë pranuar 17,219 kërkesa për ndërrimin e qendrës së votimit

- 16,503 kërkesa janë aprovuar dhe
- 716 kërkesa janë refuzuar.

### **2.4 Kundërshtimi i listës së votuesve**

Periudha e Kundërshtimit dhe Konfirmimit e Listës së Votuesve ka filluar me datën 29 gusht 2024 dhe përfunduar me datën 28 dhjetor 2024.

Gjatë kësaj periudha DVSH ka pranuar 11 kërkesa përmes emailit nga shtetasit të cilët kanë dërguar dokumentet e identifikimit dhe të cilët nuk e kanë gjetur emrin e tyre në listën e votuesve. Pas verifikimit me ARC, 11 votues janë përfshirë në listën e votuesve.

## **3 Regjistrimi i votuesve jashtë Kosovës**

Periudha e regjistrimit të votuesve jashtë Kosovës ka filluar me datë 29 gusht 2024 dhe ka përfunduar me datë 26 dhjetor 2024. Shtetasit me të drejtë vote, që jetojnë jashtë Kosovës, mund të aplikojnë për regjistrim si votues jashtë Kosovës, përmes platformës elektronike për regjistrim të votuesve jashtë Kosovës (<https://diaspora.kqz-ks.org>) dhe duke dërguar kërkesën për regjistrim përmes postës, në kutinë postare të KQZ, në Prishtinë.

Gjatë kësaj periudhe janë pranuar aplikimet për regjistrim nga 115,208 votues. Prej tyre, 114,960 votues kanë aplikuar përmes sistemit elektronik dhe 248 përmes postës, në kutinë postare të KQZ-së. Shqyrtimi i aplikimeve për regjistrim ka përfunduar me datë 28 dhjetor deri në orën 15:55. Nga 115,208 votues që kanë aplikuar:

- 104,924 janë aprovuar
- 6,872 janë refuzuar, dhe
  - 4039, ju mungon fotografia e aplikuesit me dokument identifikues të Kosovës në dorë
  - 1336, ju mungon dokumenti i vlefshëm
  - 982, ju mungon fotografia e aplikuesit me dokument identifikues të Kosovës në dorë,

- 171, ju mungon dokumenti identifikues i Republikës së Kosovës, ju mungon fotografia e aplikuesit me dokument identifikues të Kosovës në dorë, si dhe ju Mungon dokumenti i vlefshëm,
  - 34, dokumenti i identifikimit nuk përputhet me aplikuesin
  - 79, dokumentet e bashkangjitura nuk lexohen
  - 231, ju mungon dokumenti identifikues i Kosovës
- 3,412 janë anuluar,
    - 151 pas kërkesës së votuesve që të kthehen në listën brenda Kosovës
    - 3261 pas verifikimit nga DSHV,

### **3.1 Kundërshtimi administrativ dhe ankesat në PZAP**

KQZ-së me datë 21 gusht 2024 ka themeluar Komisionin për Kundërshtim Administrativ. Komisioni ka shqyrtuar kundërshtimet e pranuara përmes emailit. Periudha e kundërshtimit ka përfunduar me datë 28.12.2024. Megjithatë, shqyrtimi i aplikacioneve është bërë deri me datën 28 dhjetor në orën 15:55, andaj Komisioni ka marrë për bazë kundërshtimet e pranuar deri me date 29.12.2024 në ora 15:55. Gjatë periudhës së kundërshtimit, Komisioni ka aprovuar 21 kërkesa për kundërshtim të votuesve të cilët ishin refuzuar dhe të cilët janë aprovuar, 151 kërkesa për anulimin e regjistrimit dhe kthimin në listën e votuesve brenda Kosovës si dhe janë hedhur si të palejuara 179 kundërshtime. Pas përfundimit të shqyrtimit të aplikimeve për regjistrim janë pranuar 156 kundërshtime. KQZ me datë 30 dhjetor 2024, ka marrë vendim për aprovimin e 137 kërkesave për kundërshtim të cilët kishin dërguar dëshmitë gjatë kundërshtimit, në mungesë të cilave ishin refuzuar gjatë shqyrtimit të aplikimeve për refuzim. Ndërsa ka refuzuar 19 kërkesa për kundërshtim. Gjithsejtë, numri i kërkesave për kundërshtim është :

- 151 kërkesa të aprovuara të cilët nga statusi i refuzimit janë kthyer në të aprovuar dhe janë përfshirë në listën e votuesve jashtë Kosovës.
- 151 kërkesa për anulimin e regjistrimit dhe kthimin në listën e votuesve brenda Kosovës janë aprovuar.
- 19 kërkesa janë refuzuar.

I pakënaqur me vendimin e KQZ-së, një votues ka parashtruar ankesë në PZAP me datë 30.12.2024, dhe PZAP me datë 03.01.2025 ka marrë vendim për refuzimin e ankesës.

## **4 Lista e votuesve jashtë Kosovës**

Pas përfundimit të periudhës së regjistrimit, kundërshtimit dhe ankesave në PZAP, lista e votuesve jashtë Kosovës përmban 104,924 votues. Sipas nenit 96, paragrafit 9, votuesit të regjistruar për të votuar nga jashtë Kosovës, janë larguar nga Lista e Votuesve brenda Kosovës. Në vijim janë paraqitur të dhënat e detajuara të votuesve të regjistruar, sipas mënyrës së votimit, shteteve dhe komunave në Republikën e Kosovës.

Tabela 1- Numrin i votuesve të regjistruar jashtë Kosovës sipas mënyrës së votimit.

Mënyra e votimit	Numri i votuesve
Të dërgoj përmes postës, në kutinë postare jashtë Kosovës	67421
Të dërgoj përmes postës, në kutinë postare në Kosovë	17104
Të votoj fizikisht në Përfaqësi Diplomatike	20399
<b>Gjithsejtë</b>	<b>104,924</b>

Tabela 2- Numrin i votuesve të regjistruar jashtë Kosovës sipas shteteve.

Shteti	Numri i votuesve të regjistruar
GJERMANI	44774
ZVICËR	27248
FRANCË	4629
SUEDI	3958
AUSTRI	3932
ITALI	3810
SHBA	2509
BELGJIKË	2392
MBRETËRIA E BASHKUAR	2236
FINLANDË	1806
SLLOVENI	1468
NORVEGJI	1116
KANADA	1045
DANIMARKË	625
KROACI	490
HOLANDË	387
TURQIA	378
LUKSEMBURG	361
MALI I ZI	344
SERBI	195
HUNGARI	192
MAQEDONIA E VERIUT	165
AUSTRALIA	145
ÇEKI	139
IRLANDË	92
BOSNJE DHE HERCEGOVINA	78
RUMANIA	59
ISLANDË	49
POLONI	28

SLLOVAKIA	26
LIHTENSHTAJN	25
SHQIPËRIA	22
EMIRATET E BASHKUARA ARABE	20
SPANJË	20
KAZAKISTAN	19
PORTUGALI	16
GJEOGJIA	14
GREQIA	13
BULLGARI	12
ZELANDA E RE	10
KATAR	9
KUVAJT	8
SUDANI JUGOR	7
GJIBRALTARI	5
FILIPINE	4
TAJLANDË	4
ARABIA SAUDITE	3
IRAK	3
KENIA	3
ANGOLA	2
IZRAEL	2
JAPONI	2
MALAZIA	2
SENEGAL	2
ANDORRA	1
ARMENI	1
BAHRAIN	1
BANGLADESHI	1
BRAZIL	1
ÇAD	1
FIXHI	1
GUAJANA	1
GUAJANA FRANCEZE	1
KINA	1
LETONI	1
LITUANI	1
MALTA	1
MAURITAN	1
MONGOLI	1
NIKARAGUAJ	1

PANAMA	1
SAN MARINO	1
SURINAMI	1
UKRAINË	1
XHIBUTI	1
Gjithsejtë	104,924

*Tabela 3 - Numri i votuesve të regjistruar sipas komunës në Kosovë*

<b>Komuna</b>	<b>Numri i votuesve</b>
PRISHTINË	9089
PRIZREN	8217
GJILAN	7214
FERIZAJ	6835
PEJË	6819
GJAKOVË	6383
MITROVICË E JUGUT	5030
SUHAREKË	5007
PODUJEVË	4926
VUSHTRRI	4466
VITI	3626
MALISHEVË	3465
RAHOVEC	3451
LIPJAN	3364
DEÇAN	3111
ISTOG	3086
SKENDERAJ	2755
DRAGASH	2718
KAMENICË	2549
KLINË	2546
FUSHË KOSOVË	2005
GLLOGOVC	1922
KAÇANIK	1856
SHTIME	1602
OBILIQ	1042
JUNIK	753
HANI I ELEZIT	316
NOVOBËRDË	174
MITROVICË E VERIUT	149
SHTËRPECË	142

KLLOKOT	72
ZUBIN POTOK	63
GRAÇANICË	62
MAMUSHË	50
LEPOSAVIQ	32
ZVEÇAN	21
RANILLUG	6
Gjithsejtë	104,924

Tabela 4 - Nr. i votuesve të regjistruar për votim në përfaqësi diplomatike

Përfaqësia diplomatike e Republikës së Kosovës	Shteti	Nr. i votuesve të regjistruar
Konsullata e Republikës së Kosovës - DÜSSELDORF	Gjermani	2105
Konsullata e Republikës së Kosovës - MÜNCHEN	Gjermani	1972
Konsullata e Republikës së Kosovës - STUTTGART	Gjermani	1970
Konsullata e Republikës së Kosovës - CYRIH	Zvicër	1953
Konsullata e Republikës së Kosovës - FRANKFURT	Gjermani	1567
Ambasada e Republikës së Kosovës - LONDËR	Mbretëri e Bashkuar	1020
Konsullata e Republikës së Kosovës - GJENEVË	Zvicër	981
Konsullata e Republikës së Kosovës - BERNË	Zvicër	967
Ambasada e Republikës së Kosovës - BRUKSEL	Belgjikë	960
Ambasada e Republikës së Kosovës - VJENË	Austri	941
Ambasada e Republikës së Kosovës - BERLIN	Gjermani	793
Konsullata e Republikës së Kosovës - HAMBURG	Gjermani	759
Konsullata e Republikës së Kosovës - STRASBURG	Francë	656
Konsullata e Republikës së Kosovës - NEW YORK	SHBA	619
Ambasada e Republikës së Kosovës - OSLO	Norvegji	470
Ambasada e Republikës së Kosovës - LUBJANË	Slloveni	396
Ambasada e Republikës së Kosovës - PARIS	Francë	320
Konsullata e Republikës së Kosovës - TORONTO	Kanada	298
Ambasada e Republikës së Kosovës - STOKHOLM	Suedi	271
Konsullata e Republikës së Kosovës - KOPENHAGË	Danimarkë	195
Konsullata e Republikës së Kosovës - MILANO	Itali	189
Konsullata e Republikës së Kosovës - STAMBOLL	Turqi	170
Ambasada e Republikës së Kosovës - ZAGREB	Kroaci	153
Ambasada e Republikës së Kosovës - HAGË	Holandë	124
Ambasada e Republikës së Kosovës - ROMË	Itali	102
Ambasada e Republikës së Kosovës - OTAVË	Kanada	93
Ambasada e Republikës së Kosovës - PRAGË	Çeki	79
Ambasada e Republikës së Kosovës - WASHINGTON	SHBA	78
Ambasada e Republikës së Kosovës - BUDAPEST	Hungari	68
Ambasada e Republikës së Kosovës - SHKUP	Maqedoni e Veriut	55
Konsullata e Republikës së Kosovës - IOWA	SHBA	32

Ambasada e Republikës së Kosovës - ANKARA	Turqi	25
Ambasada e Republikës së Kosovës - KANBERA	Australi	18

## 5 Lista e Votuesve brenda Kosovës

Pas përfundimit të periudhës së konfirmimit dhe kundërshtimit, si dhe regjistrimit të votuesve jashtë Kosovës, Lista e Votuesve brenda Kosovës përmban 1,970,944 votues. Divizioni për Shërbim të Votuesve i ka caktuar votuesit nëpër vendvotime sipas renditjes alfabetike.

Kodi Komunës	Komuna	Numri i votuesve	Qendrat e votimit	Numri i vendvotimeve
1	Deçan	40976	14	50
2	Gjakovë	119237	36	145
3	Glllogovc	56703	31	72
4	Gjilan	103616	37	129
5	Dragash	40263	33	56
6	Istog	50276	21	60
7	Kaçanik	33157	21	46
8	Klinë	50706	21	62
9	Fushë Kosovë	47406	16	58
10	Kamenicë	33775	28	50
11	Mitrovicë e Jugut	81482	32	105
12	Leposaviq	13876	18	26
13	Lipjan	64341	33	84
14	Novobërdë	9820	18	22
15	Obiliq	25883	14	33
16	Rahovec	58338	35	79
17	Pejë	115679	24	132
18	Podujevë	84023	47	110
19	Prishtinë	212515	54	258
20	Prizren	182939	76	236
21	Skenderaj	53329	33	71
22	Shtime	27329	15	33
23	Shtërpcë	12864	9	17
24	Suharekë	68101	34	87
25	Ferizaj	118288	48	152
26	Viti	49054	30	63
27	Vushtrri	73713	32	96
28	Zubin Potok	6843	12	14
29	Zveçan	7203	6	11
30	Malishevë	55154	35	72



31	Junik	5292	1	7
32	Mamushë	4699	1	5
33	Hani Elezit	8641	4	12
34	Graçanicë	22819	13	31
35	Ranillug	5069	7	10
36	Partesh	4882	3	7
37	Kllokot	3872	5	8
38	Mitrovicë e Veriut	18781	6	24
	<b>Gjithsejtë</b>	<b>1,970,944</b>	<b>903</b>	<b>2533</b>

Krahas qendrave të votim të rregullta, janë edhe 38 qendra të votimit me kusht me vendvotimet përkatëse.

*Tabela 5 - Numri i qendrave dhe vendvotimeve me kusht*

<b>Kodi i Komunës</b>	<b>Komuna</b>	<b>Numri i vendvotimeve me kusht</b>
1	DEÇAN	1
2	GJAKOVË	2
3	GLLOGOVC	1
4	GJILAN	1
5	DRAGASH	1
6	ISTOG	1
7	KAÇANIK	1
8	KLINË	1
9	FUSHË KOSOVË	3
10	KAMENICË	1
11	MITROVICË E JUGUT	3
12	LEPOSAVIQ	1
13	LIPJAN	1

14	NOVOBËRDË	1
15	OBILIQ	1
16	RAHOVEC	1
17	PEJË	2
18	PODUJEVË	2
19	PRISHTINË	7
20	PRIZREN	3
21	SKENDERAJ	1
22	SHTIME	1
23	SHTËRPCË	1
24	SUHAREKË	1
25	FERIZAJ	3
26	VITI	1
27	VUSHTRRI	2
28	ZUBIN POTOK	1
29	ZVEÇAN	1
30	MALISHEVË	1
31	JUNIK	1
32	MAMUSHË	1
33	HANI I ELEZIT	1
34	GRAÇANICË	1
35	RANILLUG	1
36	PARTESH	1
37	KLLOKOT	1
38	MITROVICË E VERIUT	1
<b>Gjithsejtë</b>		<b>56</b>